



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2015 për transparencë në Komuna, të nenit 32 pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.05.2016, miratoi këtë

V E N D I M
PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE LIDHUR ME RREGULLOREN
PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

I.

Miratohet Vendimi për dërgimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në konsulta paraprake publike.

II.

Komisioni lidhur me vendimin e cekur në pikën 1, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin – qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatës informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t’i testuar dhe diskutuar propozimet.

III.

Konsultat paraprake publike për rregulloren e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të zgjasin 15 dite.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe njësitë përkatëse të administratës komunale.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.nr 031 - 134934 ,më 01.06.2016

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.



Arsyetim

Grupi punues, i formuar për hartimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, ka përgatitur propozimrregulloren dhe në pajtim me pikën a të nenit 32 të Statutit të Komunës, po ua dërgojmë për shqyrtim.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i çështjes së menaxhimit të mbeturinave komunale dhe caktimi i taksës për mbeturina. Taksa për mbeturina është caktuar duke u bazuar në Ligjin për financat e pushtetit lokal, nr.03/L-049, përkatësisht nenet 3, 13.1 dhe 15 pika f.

Për më tepër, me këtë rregullore krijohen kushtet për e menaxhimin e integruar dhe zvogëlimin e sasisë së prodhuar të mbeturinave dhe uljen e shkallës së rrezikshmërisë nga mbeturinat. Përcaktohen qartë llojet e mbeturinave që do të menaxhohen, dhe përgjegjësitë e Komunës mbi menaxhimin e mbeturinave.